

AL

**PRO-GE**  
DIE PRODUKTIONSGEWERKSCHAFT

## Kush jemi ne?

Ne jemi një sindikatë që punon fort për të drejtat e punëtorëve dhe punëtoreve. Ne mbrojmë interesat e punëtorëve dhe punëtoreve në bujqësi, bashkëpunojmë me aktivistë e aktiviste dhe organizatat joqeveritare në këtë fushë. Ne duam ta parandalojmë shfrytëzimin e punëtorëve dhe punëtoreve në bujqësi dhe kemi përvojë në zbatimin e të drejtave – po të jetë e nevojshme edhe përmes gjykatave e institucioneve shtetërore, nëse ti dëshiron.

**Ne ju këshillojmë falas dhe në mënyrë anonime!**

**Në rast se bëhesh anëtar, ne të përfaqësojmë edhe para gjyqit.**

**Informohu! Organizohu së bashku me kolegët dhe koleget e tua të punës!**

**Organizo një mbledhje të kolektivit ose ngri një këshill të sindikatës!**

**PRO-GE**  
DIE PRODUKTIONSGEWERKSCHAFT

[www.proge.at](http://www.proge.at)

 [www.facebook.com/sezonieri](https://www.facebook.com/sezonieri)

 Anlaufstelle zur  
gewerkschaftlichen  
Unterstützung  
UNDOKumentiert  
Arbeitender

 **LEFÖ**  
SEIT 1988  
BERATUNG, BILDUNG  
UND BEGLEITUNG  
FÜR MIGRANTINNEN

 **nyéléni Austria**  
Österreichisches Forum für Ernährungssouveränität

 **M:EN**  
MIGRANTEN UND  
ERWERBSMIGRANTEN



Me kodin QR shih informacionet  
tona në video mbi TË DREJTAT  
E TUA, në pesë gjuhë.

Fotos: Lisbeth Kovacic

**ÇFARË DUHET TË DISH  
KUR PUNON SI VJELËS  
OSE VJELËSE NË BUJQËSI**

**TË DREJTAT E TUA JANË QËLLIMI YNË!**

VLBG 03/2022

[www.sezonieri.at](http://www.sezonieri.at)

# ÇFARË DUHET TË DISH KUR PUNON SI VJELËS OSE VJELËSE NË BUJQËSI

## Paga ime minimale në Vorarlberg?

8,90 € bruto/në orë

7,32 € neto/në orë\*)

292,96 € neto/në javë\*)

1.268,51 € neto/në muaj\*)

\*) Pasi të jenë zbritur tatimet e përcaktuara me ligj. Pa punën jashtë orarit (orët plus).

Rroga duhet të paguhet çdo muaj dhe ju keni të drejtë të kërkonit një fletëpagesë. Të gjitha orët e punës, pavarësisht nga puna që bën, duhet të paguhet!

## Punë me akord?

Lejohet. Megjithatë duhet ta merrni pagën minimale. Shënoji patjetër orët e tua të punës!

## Koha e punës?

max. 12 orë/në ditë

max. 60 orë/në javë

Duke përfshirë të gjitha orët plus.

## Orët plus?

Të gjitha orët mbi kohën normale të punës. Orët plus duhet të paguhet të paktën 50% më shumë.

**Shëno çdo ditë orët e tua të punës, që të mund të kërkojë pagesën që mungon.**

>> informohu saktësisht për atë çka të takon te sindikata jote PRO-GE:  
[www.proge.at](http://www.proge.at)

## Ndalohet çdo punë mbi ...

12 orë/në ditë

60 orë/në javë

Punë të tilla mund t'i refuzosh në çdo kohë! Për këtë refuzim nuk lejohet që të pushohesh nga puna! Nëse punon më tepër, punëdhënësi yt dënohet nga ligji!

## Orët, të cilat shefi nuk është i detyruar të m'i paguajë:

Pushimet (të paktën 30 minuta në ditë), si dhe rrugën nga banesa për në punë dhe kthim.

## Pushimi vjetor?

Sipas ligjit ke të drejtë për leje. Nëse nuk e konsumon lejen, duhet që ajo të të paguhet, kur përfundon marrëdhënien e punës.

## Pagesa të veçanta?

Ke të drejtë për pagesën shtesë që jepet për lejen dhe pagesën shtesë për Krishtlindjet.

## Sigurim?

Me fillimin e punës në Austri ke të drejtë për sigurim shëndetësor, sigurim nga aksidentet, sigurim për pension dhe sigurim si i papunë. Kur fillon punën duhet të marrësh prej punëdhënësit një kopje të regjistrimit tënd në ÖGK.

>> Informacione se si mund ta marrësh e-card (Karta e Sigurimit nga ÖGK) i gjen te: [www.chipkarte.at](http://www.chipkarte.at)

## Banesë te shefi?

Lejohet të të kushtojë më së shumti 1,31 € në ditë (39,24 € në muaj duke përfshirë rrymën elektrike etj.).

## Çfarë duhet të përmbajë banesa ime te shefi?

- duhet të jetë e mundur që ta mbyllësh me çelës
- dollap që mund ta mbyllësh
- dritare
- ujë të pijshëm
- mundësi për t'u larë me ujë të pastër dhe të rrjedhshëm
- dritë, të cilën mund ta hapësh dhe ta mbyllësh secili veç e veç
- tualete (nevojtores) të ndara njera nga tjetra
- mundësi për të gatuar dhe për ta ngrohur ushqimin
- frigorifer
- mundësi për të terur veshjet e lagura

## Ushqim?

Nëse të jepet ushqimi i plotë pa pagesë (mëngjes, drekë, darkë dhe 2 sanduiçe me piqe), lejohet që të të kërkojnë gjithsej 6,54 € në ditë (196,20 € në muaj) për banim dhe ushqim.

## Materialet e punës

Dorashkat, mjetet e punës etj. duhet t'i marrësh pa pagesë. Për to nuk lejohet të të zbresin asgjë nga rroga.

[www.sezonieri.at](http://www.sezonieri.at)

## Ne të ndihmojmë!

Ne jemi pranë teje, në mënyrë anonime dhe për të gjitha pyetjet që ke!

✉ [sezonieri@proge.at](mailto:sezonieri@proge.at)

Na shkruaj ose na thirr në telefon:

**Deutsch:**

Karl Orthaber

☎ +43 664 6145948

**Bosanski/Hrvatski/Srpski:**

Toni Steinmetz ☎ +43 664 6145962

**Български:**

Milena Paneva ☎ +43 664 6145063

**Magyar nyelven:**

Márta Pinkert ☎ +43 2682 77066

**Romana:**

Radu Plamadeala ☎ +43 664 2885489

**український:**

Kateryna Soltani ☎ +43 677 63004411

**Shqip:**

Fisnik Lang ☎ +43 676 846954816

**Slovenski:**

Blaz Gyoha ☎ +43 664 847707

**Česky/Slovenský:**

Martina Lackner ☎ +43 664 88525655